

[Printo]

[Google Translate]

VENDIM

Nr.154, datë 11.2.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.486, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE, QË TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1 të vendimit nr.486, datë 27.7.2007, të Këshillit të Ministrave, fjalët "... brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi." zëvendësohen me "...deri më 30 qershor 2009.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Copyright 2016 - www.ligjet.org